



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 57 Akti

Nr. 115 Vendimi
Tiranë më 11.03.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli
Xhensila Pine
Roland Ilia

Kryesuese
Anëtare
Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Hans Kijlstra, më datë 04.03.2019, ora 11:00, në Pallatin e Kongreseve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë ish-Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016 “ Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015” Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 96/2016” Mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoji gjetjet e relatorit të çështjes, z. Roland Ilia, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe dokumentacionin provues të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, dhe pasi analizoi çështjen, bazuar në të tri kriteret, atë të pasurisë, figurës dhe vlerësimit profesional, sipas pikës 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si Kryeinspektore pranë ish-Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, pasi u përzgjedh me shortin e hedhur, më datë 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” (në vijim “Komisioni”).
3. Referuar nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin të rivlerësimit ka filluar menjëherë pasi u caktua trupi gjykues i Komisionit, ndërsa rasti i këtij subjekti u caktua, më datë 30.11.2017.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues, më datë 12.12.2017, u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues, znj. Firdes Shuli si dhe u deklarua mospasja e konfliktit të interesave nga ana e secilit prej anëtarëve të këtij trupi gjykues, si dhe u vendos të fillonte hetimi administrativ me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari.
5. Me vendimin nr.***, datë 23.05.2018, për shkak të gjendjes së saj shëndetësore, komisionerja Alma Faskaj u zëvendësua nëpërmjet përzgjedhjes me short nga komisionerja Xhensila Pine, e cila deklaroi se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesave.
6. Në bazë të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, administroi relacionet e përpiluara nga këto institucione: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim IKLD). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.
7. Vëzhguesi ndërkombëtar parashtrroi gjetjen e tij me shkresën me nr. *** prot., më datë 20.12.2018.
8. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit të çështjes, më datë 01.02.2019, vendosi të përfundonte hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari dhe ta njoftonte për t’u njohur me dosjen, dokumentacionin e administruar nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
9. Subjekti i rivlerësimit u njoftua se kishte të drejtën të parashtronte shpjegime/pretendime shtesë, ose të kërkonte marrjen e provave të reja në lidhje me rezultatet e hetimit më datë 01.02.2019.
10. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dokumentacionin e dosjes, më datë 04.02.2019, dhe ushtroi të drejtën për të paraqitur parashtrime dhe prova të reja, më datë 15.02.2019.

11. Pasi shqyrtoi këto shpjegime dhe prova të parashtruara nga ana e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të thërrasë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

12. Subjekti i rivlerësimit u thirr në seancë nëpërmjet njoftimit të dërguar në rrugë elektronike, më datë 20.02.2019.

- a. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit u mbajt në përputhje me parashikimet e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 04.03.2019, ora 11:00, në sallën e konferencave pranë Pallatit të Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra.
- b. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit dha shpjegimet e saj dhe ia parashtrroi ato Komisionit me shkrim.
- c. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

13. Në bazë të rezultateve të hetimit dhe shpjegimeve të paraqitura në seancën dëgjimore, trupi gjykues, ka shpallur më datë 11.03.2019, përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.

II. PËRFUNDIMI I PROCESIT TË RIVLERËSIMIT PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR

II/a Statusi i magjistratit

1. Si rezultat i hetimit administrativ u ngritën disa dyshime për faktin nëse subjekti i rivlerësimit e kishte statusin e magjistratit apo jo. Kjo çështje merr një rëndësi të veçantë për qëllimin e rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 84/2016 si dhe nenin 165 dhe 168 të ligjit nr. 96/2016.

2. Sipas pikës 2 dhe 4 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i inspektorëve që nuk janë magjistratë, do të bazohet në: (i) dokumentet ligjore; dhe (ii) rezultatet e testimi nga Shkolla e Magjistraturës.

3. Duke ndjekur të njëjtën logjikë, neni 165, i ligjit nr. 96/2016, parashikon se, inspektorët që nuk kanë statusin e magjistratit do t'i nënshtrohen testimi nga Shkolla e Magjistraturës si pjesë e procesit të rivlerësimit të tyre. Neni 168 i të njëjtit ligj parashikon se, Kryeinspektori dhe inspektorët e tjerë që gëzojnë statusin e magjistratit, do të konsiderohen si magjistratë dhe do të vlerësohen sipas ligjit për rivlerësimin kalimtar.

4. Për sa më sipër, Komisioni, hetoi nëse subjekti i rivlerësimit e kishte statusin e magjistratit.

5. Pasi analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit mbi karrierën e saj profesionale dhe raportin e IKLD-së mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, janë ndërmarrë hapat e mëposhtëm hetimorë, për të përcaktuar nëse subjekti i rivlerësimit ka statusin e magjistratit:

- (i) kërkesë pranë KLD-së për të vënë në dispozicion dokumentacion provues mbi dosjen personale të subjektit të rivlerësimit¹;

¹ Shkresa nr. *** prot, datë 20.10.2018.

- (ii) kërkesë pranë KLD-së për të vënë në dispozicion dokumentacion provues mbi emërimin e subjektit të rivlerësimit si Kryeinspektore²;
- (iii) kërkesë pranë KLD-së për të vënë në dispozicion informacion mbi çdo kërkesë të subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar brenda gjyqësorit (në Gjykatën e Krimeve të Rënda ose gjykata të tjera³);
- (iv) kërkesë pranë Departamentit të Administratës Publike për të vënë në dispozicion informacion mbi statusin e nëpunësit civil të subjektit të rivlerësimit⁴.

6. Pas analizimit të dokumenteve dhe informacionit të administruar u konstatua se:

- (i) subjekti ka shërbyer si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier nga viti 1999 deri në dhjetor 2007;
- (ii) subjekti ka paraqitur një kërkesë pranë KLD-së në dhjetor të vitit 2007, për të shërbyer në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë (MD);
- (iii) në dhjetor të vitit 2007, subjekti filloi të punojë si këshilltare në kabinetin e Ministrit të Drejtësisë, deri në shtator 2008;
- (iv) nga shtatori 2008 deri në janar 2013, subjekti u caktua Drejtoreshë e Përgjithshme (e Kodifikimit dhe Çështjeve të Drejtësisë) në Ministrinë e Drejtësisë;
- (v) në prill të vitit 2011, subjekti u emërua në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë si nëpunëse civile. Në shtator të vitit 2012, subjekti u konfirmua si nëpunëse civile pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- (vi) në janar të vitit 2013, subjekti paraqiti një kërkesë për t'u emëruar Kryeinspektore në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. KLD-ja e pranoi kërkesën dhe nga janari 2013 subjekti shërben në këtë pozicion.

7. Ruajtja e statusit të gjyqtarit, për gjyqtarët që shërbenin në struktura jashtë gjyqësorit ishte rregulluar me ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Sipas nenit 30/a të këtij ligji:

- *Gjyqtarët mund të shërbejnë në nivele drejtuese të kabinetit të ministrit dhe strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë. Periudha e shërbimit civil të tyre në këto struktura njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat e ligjeve mbi organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe të Prokurorisë.*
- *Gjyqtarët që shërbejnë si nëpunës civilë në Ministrinë e Drejtësisë, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë a prokurorë pa konkurs.*

8. Ndërsa në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” i ndryshuar, në vitin 2003, parashikohet se: “Gjyqtarët dhe prokurorët mund të shërbejnë si këshilltarë ligjorë dhe në nivele drejtuese ose ekzekutive të strukturave juridike profesionale të Ministrisë së Drejtësisë; dhe gjithashtu se riemërohen si gjyqtarë pa konkurs.” (neni 4 i ligjit).

9. Pasi subjekti i rivlerësimit filloi të shërbejë në kabinetin e Ministrit të Drejtësisë në dhjetor 2007, më 15 mars 2008, hyri në fuqi një ligj i ri mbi organizimin e gjyqësorit. Ligji nr. 9877/2008 hyri në fuqi më 15 mars 2008. Për sa i përket dispozitave të reja ligjore të ligjit nr.

² Shkresa nr. *** prot., datë 11.10.2018.

³ Shkresa nr. *** prot., datë 26.10.2018.

⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 26.10.2018.

9877/2008, mbi ruajtjen e statusit të gjyqtarit për gjyqtarët që shërbejnë jashtë gjyqësorit, vërehet se:

10. Ligji nr. 9877/2008, parashikon një maksimum prej 3 vjetësh për gjyqtarët që shërbejnë në strukturat jashtë gjyqësorit, periudhë pas së cilës ata duhet të kthehen në pozicionet e tyre të mëparshme, ndërsa ligji i mëparshëm nr. 8436/1998 , nuk parashikonte asnjë afat kohor për gjyqtarët që shërbenin jashtë pushtetit gjyqësor. Subjekti kurrë nuk u kthye në strukturat e gjyqësorit dhe asnjëherë nuk paraqiti asnjë kërkesë për t'u kthyer në pozicionin e saj të mëparshëm, që nga dhjetori 2007 dhe deri më sot.

11. Për sa më sipër, trupi gjykues, çmon se:

- (i) Në mars të vitit 2008, ligji vendosi afat 3-vjeçar për gjyqtarët që shërbejnë në strukturat jashtë gjyqësorit.
- (ii) Duke qenë se në ligjin nr. 9877/2008 nuk ka dispozita kalimtare në lidhje me këtë afat, afati bëhet i zbatueshëm menjëherë me hyrjen në fuqi të ligjit.
- (iii) Kjo do të thotë se afati për të shërbyer jashtë strukturave të gjyqësorit, duke ruajtur njëkohësisht statusin e gjyqtarit, për subjektin e rivlerësimit, ka përfunduar në muajin mars të vitit 2011.
- (iv) Si pasojë e kësaj, subjekti i rivlerësimit e ka humbur *ex lege*, statusin e gjyqtarit.
- (v) Nuk ka qenë e nevojshme gjithashtu dhënia e ndonjë vendimi konstitutiv të KLD-së, për t'i rikthyer statusin.

II/b Argumentet kundërshtuese të subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë çështje

1. Sipas subjektit të rivlerësimit, efekti prapaveprues i ligjit të ri, lidhur me afatin maksimal të zbatueshëm për ruajtjen e statusit, shkel parimin themelor të sigurisë juridike dhe krijon ndryshim përkeqësues për të (*reformatio in peius*).

- (i) Lidhur me këtë qëndrim të subjektit, trupi gjykues gjykon se zbatimi i afatit 3-vjeçar për të shërbyer jashtë gjyqësorit, duke ruajtur statusin e gjyqtarit, fillon nga muaji mars i vitit 2008, dhe nuk ka efekt prapaveprues. Zbatimi i afatit 3-vjeçar nuk ka efekte prapavepruese. Ky afat është i zbatueshëm menjëherë me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9877/2008, duke qenë se ky ligj nuk përmbante dispozita kalimtare të posaçme për sa i përket afatit dhe njëkohësisht përmbante dispozita të qarta mbi shfuqizimin e ligjit nr. 8436/1998.
- (ii) Ligji nr. 8436/1998 nuk i jepte subjektit të rivlerësimit të drejtën të punonte jashtë sistemit gjyqësor, pa humbur statusin e magjistratit/gjyqtarit, dhe as të drejtën të punonte jashtë gjyqësorit duke mos e humbur këtë status pa afat. Ligji nr. 8436/1998 parashikonte mundësinë për të punuar si gjyqtar jashtë gjyqësorit. Kjo do të thotë se nuk ka shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe as ndonjë *reformatio in peius*.
- (iii) Për sa u përket pritshmërive legjitime, të cilave u referohet subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues nuk e konsideron si të ligjshme pritshmërinë që ajo duhej të punonte jashtë gjyqësorit për një afat kohor të pacaktuar, duke mos humbur statusin, nëse supozojmë se ka ekzistuar ndonjë pritshmëri e tillë. Subjekti i rivlerësimit duhej të kishte qenë në dijeni të rëndësisë, parë gjithashtu nga pikëpamja kushtetuese, të kufizimeve të shërbimit të një gjyqtari jashtë sistemit gjyqësor. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit duhej të kishte qenë në dijeni të mundësisë që me kalimin e kohës, ndryshimet e mundshme ligjore mund të sillnin edhe kufizime në sens shtrëngues.

2. Sipas subjektit të rivlerësimit, ruajtja e statusit të magjistratit/gjyqtarit mbështetet edhe në ligjin për organizimin e Ministrisë së Drejtësisë. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky ligj nuk përmban ndonjë afat për shërbimin jashtë gjyqësorit. Për pasojë, sipas subjektit të rivlerësimit, ajo e ka ruajtur statusin e gjyqtarit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit i referohet ligjit për organizimin dhe funksionimin e KLD-së nr. 8811/2001 dhe ligjit për qeverisjen e sistemit të drejtësisë nr. 115/2016.
 - (i) Lidhur me këtë qëndrim të subjektit, trupi gjykues gjykon se ligji për organizimin e Ministrisë së Drejtësisë nuk mund të bëjë rregullime mbi statusin e gjyqtarit dhe se ky ligj rregullon organizimin e një pjese të organeve të pushtetit ekzekutiv në Republikën e Shqipërisë. Duke pasur parasysh ndarjen e pushteteve në Kushtetutën e Shqipërisë, ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor është ai që rregullon statusin e gjyqtareve, dhe jo ligji për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë.
 - (ii) E njëjta logjikë vlen *mutatis mutandis* edhe për ligjet e tjera, të cilave u referohet subjekti i rivlerësimit.
3. Subjekti i rivlerësimit i referohet nenit 168 të ligjit për statusin e magjistratit nr. 96/2016 dhe nenit 283, pika 10, të ligjit për qeverisjen e sistemit të drejtësisë nr. 115/2016 . Sipas subjektit të rivlerësimit këto dispozita konfirmojnë se ajo mban statusin e magjistratit/gjyqtarit.
 - (i) Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues ka konstatuar se, këto dispozita kalimtare zbatohen vetëm për inspektorët që kanë statusin e gjyqtarit pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016.
 - (ii) Interpretimi i këtyre dispozitave, sipas optikës së subjektit të rivlerësimit, do të sillte si pasojë që të gjithë inspektorët që nuk e kishin statusin e gjyqtarit para hyrjes në fuqi të këtyre ligjeve, të përfitonin statusin e gjyqtarit. Ky do të ishte një rezultat i paarsyeshëm.
4. Subjekti i rivlerësimit i referohet faktit se konsiderohet se një sërë organesh/institucionesh e konsiderojnë atë si subjekt me statusin e magjistratit.
 - (i) Trupi gjykues nuk e kundërshton këtë, por ky fakt nuk mund të jetë vendimtar në përcaktimin nëse subjekti i rivlerësimit mban statusin e gjyqtarit. Ligji është vendimtar për këtë çështje.
5. Subjekti i rivlerësimit është shprehur se gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar, përveç fakteve dhe rrethanave faktike të përmendura aty, nuk duhet të merret parasysh nga Komisioni.
 - (i) Lidhur me sa më sipër, Komisioni vlerëson se pavarësisht nëse parashtrimet në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar mund të konsiderohen si gjetje në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues, është mbështetur në gjetjet e veta mbi faktet dhe arsyetimet e veta, për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit/gjyqtarit.
 - (ii) Kjo do të thotë që, pikëpamja e subjektit të rivlerësimit për këtë çështje, nuk çon në një rezultat të ndryshëm nga ai i vlerësuar nga Komisioni.

II/c Çështje të tjera që lidhen me shërbimin jashtë gjyqësorit

1. Subjekti i rivlerësimit, gjatë viteve 2008 – 2013, ka shërbyer në institucione jashtë gjyqësorit që nuk parashikohen në ligjin nr. 9877/2008. Subjekti i rivlerësimit nuk e mohon se ka shërbyer në institucione të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji nr. 9877/2008, por sipas saj, pozicionet ku ka shërbyer kanë qenë me kohë të pjesshme, në raste episodike, si dhe pjesë e pozicioneve të saj në Ministrinë e Drejtësisë ose si pasojë e urdhrave të eprorëve të saj.

(i) Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, nuk e ndryshojnë faktin që ajo ka shërbyer në pozicione që nuk parashikohen nga ligji mbi organizimin e gjyqësorit nr. 9877/2008.

2. Gjatë seancës, subjekti i rivlerësimit deklaroi se, kurrë nuk ka menduar gjatë 11 viteve punë jashtë gjyqësorit mbi mundësinë e humbjes së statusit së gjyqtarit. Ajo u ballafaqua me këtë mundësi kur lexoi rezultatet e hetimit të paraqitura nga Komisioni.

(i) Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues thekson se, ka pasur disa momente të mëparshme në kohë ku subjekti i rivlerësimit është përballur në punën e saj me çështjet që lidhen me statusin e saj, si në momentin kur është zgjedhur Kryeinspektore e Këshillit të Lartë të Drejtësisë; në rastin e njoftimit të Shkollës së Magjistraturës për subjektet/inspektorët që nuk kanë statusin e magjistratit (arsye pse duhej t'i nënshtroheshin testimit pranë kësaj shkolle); si dhe në momentin e kalimit të barrës së provës nga Komisioni. Ky qëndrim i mbajtur nga subjekti i rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore u çmua nga trupi gjykues si një neglizhencë e subjektit të rivlerësimit në lidhje me ruajtjen ose jo të statusit të magjistratit, pasi në mënyrë të përsëritur subjekti i rivlerësimit, gjatë punës së saj, ka pasur mundësinë të reflektonte dhe nuk ka reflektuar.

II/d Testimi në Shkollën e Magjistraturës

1. Vlerësimi i aftësive profesionale të Kryeinspektorit të KLD-së rregullohet në nenin 42 të ligjit nr. 84/2016; dhe nenet 165 dhe 168 të ligjit nr. 96/2016.

(i) Sipas paragrafit 2 dhe 4 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, inspektorët që nuk janë magjistratë, do të vlerësohen në bazë të: (i) dokumenteve ligjore që kanë përgatitur; dhe (ii) rezultateve të testimit në Shkollën e Magjistraturës.

(ii) Në të njëjtën linjë, neni 165 i ligjit nr. 96/2016, parashikon se, këshilltarët juridikë, inspektorët etj., që nuk kanë statusin e magjistratit, duhet të testohen në Shkollën e Magjistraturës si pjesë e procesit të rivlerësimit profesional të tyre. Neni 168 i të njëjtit ligj, parashikon që Kryeinspektori dhe inspektorët që mbajnë statusin e magjistratit, do të konsiderohen si magjistratë dhe do të vlerësohen në përputhje me ligjin për rivlerësimin kalimtar. Pra, për inspektorët që kanë statusin e magjistratit nuk kërkohet testimi për vlerësimin e aftësive profesionale.

2. Subjekti i rivlerësimit, ka pretenduar se neni 165 i ligjit nr. 96/2016, nuk gjen zbatim në rastin e saj. Sipas subjektit të rivlerësimit ajo e ka ezauruar testimin në Shkollën e Magjistraturës para 20 vitesh me studime të plota 3-vjeçare dhe se, siç ka përmendur në shpjegimet e saj, ajo gëzon statusin e magjistratit dhe nuk ka nevojë për testim pranë Shkollës së Magjistraturës.

3. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se është i pasaktë, pasi subjekti e ka humbur statusin sipas argumenteve të parashtruara më sipër. Si pasojë, subjekti duhet të testohet në Shkollën e Magjistraturës si pjesë e procesit të rivlerësimit. Kjo procedurë nuk është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit dhe është konstatuar se subjekti nuk i është nënshtruar testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

II/e Pamundësia për të përfunduar procedurën e rivlerësimit

1. Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” e detyron Komisionin ta bazojë vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit që nuk e ka statusin e magjistratit, mbi rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.
2. Për sa kohë që këto rezultate nuk janë të disponueshme, trupi gjykues, nuk mund të kryejë vlerësimin e aftësive profesionale dhe nuk mund të kryejë rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 4, pika 6 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 11.03.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Xhensila PINE
Anëtare/ Kundër

Roland ILIA
Relator

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore

MENDIM PAKICE

Unë, Xhensila Pine, anëtare e trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, kam votuar kundër arsyetimit të shumicës i cili ka vendosur të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.

Vota kundër qëndrimit të shumicës është e lidhur me dy aspekte, njëri për kuadrin ligjor të zbatueshëm, kurse tjetri, për natyrën procedurale dhe vendimmarrjen përfundimtare, e cila është konsekuencë e qëndrimit për kuadrin ligjor të zbatueshëm.

I. Për sa i përket kuadrin ligjor të zbatueshëm

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin 2000. Në periudhën 2000 – 2007 ka punuar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

2. Në 6 dhjetor 2007, znj. Marsida Xhaferllari, i ka paraqitur kërkesë Ministrit të Drejtësisë nëpërmjet të cilës ka kërkuar dhënien e pëlqimit paraprak nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”), për të shërbyer në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, bazuar në ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. Miratimi i kërkesës së saj nga ana e KLD-së, ka çuar në një procedurë vendimmarrjeje të garantuar, që i ka njohur subjektit të rivlerësimit të drejtën e rikthimit në detyrë, pa afat.

4. Në vijim, situata faktike e subjektit të rivlerësimit ka qenë e njëjtë dhe ka mbetur e pandryshuar (*rebus sic stantibus*), për periudhën 17 dhjetor 2007 - 17 janar 2013, kur ajo ka shërbyer në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë.

5. Situata faktike e subjektit të rivlerësimit ka qenë e njëjtë edhe pas 17 janarit 2013, kur ka kaluar në pozicionin e Kryeinspektore së Inspektoratit të KLD-së, duke ruajtur statusin e gjyqtarës sipas nenit 15 të ligjit nr. 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”.

6. Para datës 13 janar 2018, kur përfundonte detyra e saj, Kryeinspektore e Inspektoratit të KLD-së, hynë në fuqi 2 ligje të reja, ligji nr. 96/2016 “Për Statusin e Magjistratit”, dhe ligji nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes”, të cilat shfuqizuan ligjin nr. 8811/2001 dhe përcaktuan statusin e magjistratit, të subjektit të rivlerësimit në dispozitat kalimtare të tyre.

6.1 Situata faktike e pandryshuar, rezulton edhe në provën e paraqitur nga subjekti rivlerësimit, kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.5.2013, e Zëvendëskryetarit të KLD-së për Kryetarin e Gjykatës së Lartë, me të cilën përcillet lista e gjyqtarëve që shërbejnë në strukturat e tjera shtetërore që kanë statusin e gjyqtarit, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit.

I/A Për sa i përket fuqisë ligjore të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

7. Në analizë të rrethanave të bëra prezente më sipër, kam ndarë qëndrim të ndryshëm për sa i përket arsyetimit të shumicës së trupit gjykues se: “*Ligji i ri nr. 9877/2008, parashikon një maksimum prej 3 vjetësh për gjyqtarët që shërbejnë në strukturat jashtë gjyqësorit, periudhë pas së cilës ata duhet të kthehen në pozicionet e tyre të mëparshme. Subjekti kurrë nuk u kthye*”

në strukturat e gjyqësorit dhe kurrë nuk paraqiti një kërkesë për t'u kthyer në pozicionin e saj të mëparshëm, që nga dhjetori 2007 dhe as sot”.

8. Në vlerësimin tim, bazuar në parimin se ligjet në Republikën e Shqipërisë i shtrijnë efektet për marrëdhëniet juridike që lindin pas hyrjes së tyre në fuqi, afati 3-vjeçar që ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 parashikonte, do të kishte fuqi vetëm ndaj gjyqtarëve të rekrutuar në strukturat jashtë gjyqësorit, pas hyrjes në fuqi të tij dhe nuk mund të kishte fuqi prapavepruese ndaj gjyqtarëve të rekrutuar në strukturat jashtë gjyqësorit, përpara hyrjes në fuqi të tij, pasi ky interpretim do të vinte në kundërshtim me:

8.1 Sa teoria e së drejtës pranon se fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim, vetëm në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm dhe në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme dhe për sa kohë ka pasur një interes publik të qenësishëm, i cili do të kishte përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike⁵.

8.2 Sa Gjykata Kushtetuese është shprehur se sa i takon: “...të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese⁶, nocionit të fuqisë prapavepruese, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm në qoftë se cenon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese².”

9. Kam ndarë qëndrim të ndryshëm për sa i përket arsyetimit të shumicës së trupit gjykues se: *subjekti i rivlerësimit duhej të kishte qenë në dijeni të mundësisë që me kalimin e kohës, kufizimet do të vinin duke u shtrënguar.*

10. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit, nuk mund të vihej para kufizimeve që do të vinin duke u shtrënguar prej ndryshueshmërisë të ligjit i cili përkeqësonte një gjendje të vendosur me një ligj të mëparshëm, pasi kjo do të vinte në kundërshtim me sa Gjykata Kushtetuese është shprehur në shumë vendime të saj se: “*Doktrina e së drejtës kushtetuese ka pranuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësorë të shtetit të së drejtës. Kjo siguri presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nuk do të kishim të bënim me një rast të garantimit të besueshmërisë në sistemin e normave juridike nëse siguria lidhur me një situatë të caktuar juridike nuk mund të justifikohet dhe nuk mund të mbrohet materialisht”.*

11. Për më tepër, kam vlerësuar se, znj. Marsida Xhaferllari, në kohën kur kishte përfunduar procedurat ligjore, për të shërbyer në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, nuk mund të detyrohej të ndiqte të tjera procedura ligjore, për arsye të ndryshimit të ligjit.

12. Kam ndarë qëndrim të ndryshëm edhe për sa i përket arsyetimit të shumicës së trupës gjykuese se: *Duke qenë se në ligjin nr. 9877/2008 nuk ka dispozita kalimtare në lidhje me këtë afat, afati bëhet i zbatueshëm menjëherë me hyrjen në fuqi të ligjit. Kjo do të thotë se ky afat ka përfunduar në muajin mars të vitit 2011”.*

13. Në vlerësimin tim, është vetë ligji procedural ai që duhet të përcaktojë se si duhet vepruar me rastin e hyrjes në fuqi të tij. Vetëm nëpërmjet një dispozite kalimtare të shprehur për marrëdhëniet juridike që kishin lindur para hyrjes në fuqi të tij, do të bëhej i mundur arsyetimi se qëllimi i ligjvënësimit me miratimin e ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, ka qenë miratimi i një ligji me efekte prapavepruese edhe për marrëdhënie që kanë lindur para hyrjes të tij në fuqi.

⁵ Vendimi nr. 9, datë 26.2.2007 i Gjykatës Kushtetuese.

⁶ Vendim nr. 1, datë 31.1. 2003 i Gjykatës Kushtetuese.

14. Mungesa e kësaj dispozite kalimtare të shprehur, kam vlerësuar, se çon në përfundimin se dispozitat ligjore të zbatueshme për subjektin e rivlerësimit kanë qenë ato të ligjit të kohës, ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, i ndryshuar.

I/B Për sa i përket fuqisë ligjore të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar

15. Kam ndarë qëndrim të ndryshëm për sa i përket arsytimit të shumicës së trupit gjykues se: *“Ligji për organizimin e Ministrisë së Drejtësisë nuk mund të bëjë rregullime mbi statusin e gjyqtarit dhe se ky ligj rregullon organizimin e një pjese të ekzekutivit të shtetit. Duke pasur parasysh ndarjen e pushteteve në Kushtetutën e Shqipërisë, ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor është ai që rregullon statusin e gjyqtareve”*.

17. Nuk jam pajtuar argumentimin e shumicës se ligji nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, nuk mund të bëjë rregullime për statusin e gjyqtarit, pasi në vlerësimin tim, gjyqtarët jo vetëm i përkasin gjyqësorit në përgjithësi dhe marrin pjesë drejtpërsëdrejti në dhënien e drejtësisë, por nuk ka vend të pranohet se ka cenim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve kur nga pjesë të pushtetit gjyqësor krijohen organe të pushtetit tjetër.

18. Parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve i parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës, u jep mundësi të tri degëve të qeverisjes (legjislativit, ekzekutivit e gjyqësorit), jo vetëm të respektojnë njëri-tjetrin në ushtrimin e funksioneve të tyre, por edhe të ndihmohen në mënyrë të ndërsjellë me qëllim të funksionimit sa më të mirë, për të siguruar shkallë garancie, nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që garantojnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm midis pushteteve, pa cenuar dhe pa ndërhyrë në kompetencat e njëri-tjetrit⁷.

19. Të gjitha dispozitat e ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, jo vetëm që nuk bien në kundërshtim me sa më sipër, por ato janë në përputhje me parimet themelore kushtetuese, në funksion të afirmimit dhe zbatimit të tyre. Ndaj zbrërthimi i dispozitave të këtij ligji, si dhe një vendosje në raport të drejtë e qëllimit të këtij parashikimi ligjor, me mjetet që përdor ligjvënësi për arritjen e tij, do të çonte në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, i përket pushtetit gjyqësor dhe jo një pushteti tjetër.

20. Me punësimin e saj në Ministrinë e Drejtësisë, subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, ka marrë një pozicion “*sui generis*”, funksionet e saj si gjyqtare “ngrijnë”, por kurrsesi nuk mund të pranohet se ajo largohet nga këto funksione. Në referim të ligjit, rikthimi i saj në funksionin e gjyqtares, pas mbarimit të punësimit në Ministrinë të Drejtësisë nuk lidhej me asnjë kusht që parashikohej nga dispozitat ligjore për rekrutimin “*ex-novo*” të gjyqtarëve dhe periudha i njihej si vjetërsi pune si gjyqtare për efekt të kërkesave të karrierës profesionale.

I/C Për sa i përket mbajtjes së funksioneve të tjera në Ministrinë e Drejtësisë

21. Nuk jam pajtuar me arsytimin e shumicës se, *subjekti i rivlerësimit ka shërbyer në institucione që nuk parashikohen në ligjin nr. 9877/2008*, pasi kam vlerësuar se veprimtaria e subjektit të rivlerësimit si gjyqtare që shërbente në struktura shtetërore, jashtë sistemit gjyqësor, në kushtet kur funksionet e saj si gjyqtare “ngrijnë”, nuk i ka të aplikueshme ndalimet e parashikuara për gjyqtarin, i cili ushtron efektivisht këtë detyrë.

⁷ Vendim nr. 24, datë 10.11.2006, dhe vendimi nr. 19, datë 3.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese.

22. Subjekti i rivlerësimit si gjyqtare që shërbente në struktura shtetërore jashtë sistemit gjyqësor, në vlerësimin tim, ka pasur të aplikueshme vetëm ndalimet e parashikuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, për rastet e konfliktit të interesave të parandalimit dhe zgjidhjes së tyre.

II. Për sa i përket testimit në Shkollën e Magjistraturës të subjektit të rivlerësimit

23. Nuk jam pajtuar me arsyetimin e shumicës edhe me detyrimin e subjektit të rivlerësimit për testimin në Shkollën e Magjistraturës, pasi përveç për sa kam arsyetuar më sipër, në lidhje me statusin e gjyqtarës që ajo ka mbajtur, në vlerësimin tim, neni 165, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” duhet interpretuar në përputhje me Kushtetutën, e cila “inspektorin” dhe “kryeinspektorin” i trajton veçmas në nenin 179/b, pika 3, duke u dhënë identitetet të ndryshëm Kushtetues.

24. “Kryeinspektor në detyrë” është parashikuar vetëm në nenin 168, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kjo dispozitë, nuk parashikon testimin në Shkollën e Magjistraturës, konfirmuar kjo edhe me provën e depozituar nga subjekti në njoftimin nr. *** prot., datë 26.3.2018, të Shkollës së Magjistraturës, për zhvillimin e testimit për inspektorët që nuk kanë status, në të cilin nuk përfshihet subjekti i rivlerësimit.

25. Nga sa më sipër, kam vlerësuar se testimi në Shkollën e Magjistraturës, si kërkesë e nenit 42, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” nuk aplikohet ndaj “Kryeinspektorit”, por vetëm ndaj inspektoreve jo magjistratë.

III. Për sa i përket aspektit procedural dhe vendimmarrjes përfundimtare

26. Në aspektin procedural, me nisjen e procedurës së rivlerësimit për znj. Marsida Xhaferllari, janë verifikuar juridiksioni, kompetenca dhe legjitimiteti i saj, dhe gjatë hetimit administrativ nuk janë shfaqur rrethana ligjore, të ndryshme nga ato të fillimit, të tilla që të kenë shkaktuar bërjen të pamundur të vazhdimin të procesit të rivlerësimit për këtë subjekt rivlerësimi.

27. Në konkluzion, për shkaqet e analizuara sa më lart, kam vlerësuar se përfundimi i shumicës së trupit gjykues, se subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, është në kushtet e mungesës së statusit të gjyqtarit, nuk gjen mbështetje në kuptim të parashikimeve ligjore. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Xhaferllari, ka statusin e gjyqtarës; e si rrjedhim procesi i rivlerësimit për të duhej përfunduar me vendim përfundimtar në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ANËTARE

Xhensila PINE